



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2024

Datë: 25.07.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01nr.011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 25.07.2024 pas diskutimit lidhur me pikën e 6 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-00468-27, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-00468-27, me sipërfaqe të parcelës 2215m² Zona Kadastrale Gjakovë-Qytet, së bashku me objektin -lokalin të quajtur "Blini" me numër të njësisë 468-26-599-0 me sipërfaqe të ndërtësës 169.4 m², në pronësi të Komunës së Gjakovës, me këtë përbërje:

1. z. Arben Bakalli, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës .
2. z. Kosovar Alija, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
3. znj. Krenare Bushaj, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
4. z. Besim Kadrija, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
5. znj. Erblina Dinarama, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar .

2. Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Anëtareve të Komisionit Vlerësues .
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
- Arkivit .

